

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1103 Rep.
Nr. — Kol.

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BALLA TOURS" SHPK**

NË TIRANË, SOT MË DATË 18.11.2005 (DYMIJË E PESË), PARA MEJE NOTERIT TE DHOMËS SE NOTEREVE TIRANE, U PARAQIT PERSONALISHT, NAZMI BALLA, SHTETAS SHQIPTAR, LINDUR NE TIRANE ME DATE 07.01.1953, MBAJTËS I PASAPORTES ME NR. Z 0189759, MADHOR E ME ZOTËSI TË PLOTE PËR TË VEPRUAR, I CILI ME VULLNETIN E TIJ TE LIRE E TE PLOTE NËPËRMJET KËTIJ AKTI, THEMELON SOT NJE SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE KUSHTEVE TE PARASHIKUARA ME POSHTE.

**I.
KRIJIMI**

Z. Nazmi Balla, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 07.01.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759, themelon një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emërtimin: "BALLA TOURS" Sh.p.k (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**II.
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt kryesor te saj kryerjen e aktiviteteve tregtarë në fushën e transportit tokësor të udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet organizimit te linjave te rregullta te transportit brenda dhe jashtë vendit, si dhe udhëtimeve charter. Gjithashtu objekt kryesor i aktivitetit te shoqërisë do te jete ai i agjencisë turistike dhe transportit turistik.

Për te bere te mundur arritjen e objektit te saj, Shoqëria me vendim te organit administrativ mund te nënshkruaje kontrata agjencie, komisioni, përfaqësie dhe mandati, te nënshkruajë marrëveshje qiraje, shitje, hipotekimi te pasurive te paluajtshme, si dhe te nënshkruajë çdo kontrate tjetër te nevojshme për arritjen e objektit te mësipërm. Shoqëria mund te kërkojë kredi si dhe të japë dorëzani dhe garanci të tjera reale apo personale për detyrimet e saja apo të të tretëve.

Me qellim arritjen e objektit te saj, Shoqëria me vendim të organit administrativ, mund te zotërojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kane objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të.

[Handwritten signature]



III. SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën Bulevardi Zogu I, nr. 62/2, Ap. 19 IV. Me vendim të organit administrativ, Shoqëria mund të hapë zyra përfaqëse, dege, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

IV. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, duke nisur nga regjistrimi i saj pranë Regjistrimit Tregtar.

V. ORTAKU I VETËM

Ortak i Vetëm i Shoqërisë është Nazmi Balla, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me datë 07.01.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759.

Ortak i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) transferimin të tre të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si dhe me emërimin e shkarkimin e ekspertit(eve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si dhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shpërndarjen e likuidimit të Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(eve) e çdo vendim tjetër që sipas ligjit apo këtij statuti i takon Ortakut të Vetëm.

VI. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë (njëqind mijë) i cili ndahet në 100 (njëqind) kuota me vlerë nominale 1000 (një mijë) Lekë secila. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në para nga Ortaku i Vetëm:

- **Nazmi Balla** i cili zotëron 100 kuota, me vlerë nominale të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Leke, që përbenë 100% të kapitalit të Shoqërisë;

Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm për detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e saj themeltar.

VII. ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm. Administratori i Vetëm ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori i Vetëm përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori i Vetëm ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë pa asnjë kufizim kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë

Akti i Themelimit të Balla Tours Shpk.

çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryeje veprime tërheqëse e derdhje shumë nga këto llogari pa limit.

Administratori i Vetëm mund të ndërmarre apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që i konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të shoqërisë. Administratori i Vetëm emërohet për një kohëzgjatje pa afat. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.

Administratori gjatë kryerjes së funksioneve të tij, ndjek direktivat e Ortakut të Vetëm për aktet për të cilat kërkohet miratimi i tij. Administratori i Vetëm i ushtron të drejtat e mësipërme drejtpërdrejt apo duke ja deleguar një pjesë apo të gjitha personave të tretë të zgjedhur prej tij. Administratori është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimeve të këtyre personave.

Administratori i parë i shoqërisë është Z. Nazmi Balla, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me datë 07.01.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759, banues në Bulevardi Zogu I, nr. 62/2, Ap. 19 IV Tiranë.

UNË NOTERI I DHOMËS SE NOTEREVE TIRANE, LEXOJ ME ZË TE LARTE TEKSTIN E KËTIJ AKTI THEMELIMI Z. NAZMI BALLA, DHË PASI AI ME DEKLARON SE E GJENE PËRMBAJTJEN NE PËRPUHTJE ME VULLNETIN E TIJ TE PLOTE E TE LIRE, E NËNSHKRUAN RREGULLISHT NE PRANINË TIME DHE UNË NOTERI VËRTETOJ KËTË SIPAS LIGJIT.

Nazmi Balla:

Nazmi Balla

Margena Çela

NOTERI

NOTERE
MARGENA ÇELA
CEL: 069 21 21 67

STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGESI TE KUFIZUAR
BALLA TOURS SHPK



EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

Neni 1. –

Emërtimi i Shoqërisë

1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “BALLA TOURS” SHPK., me poshtë e quajtur “Shoqëria”.

Neni 2. –

Selia

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne Tirane, ne adresën Bulevardi Zogu I, nr. 62/2, Ap. 19 IV. Me vendim te organit administrativ, Shoqëria mund te hape zyra përfaqësie, dege, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3. –

Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar, duke nisur nga regjistrimi i saj pranë Regjistrimit Tregtar.

Neni 4. –

Objekti i Shoqërisë

4.1 Shoqëria ka për objekt kryesor te saj kryerjen e aktiviteteve tregtarë në fushën e transportit tokësor të udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet organizimit te linjave te rregullta te transportit brenda dhe jashtë vendit, si dhe udhëtimeve *charter*. Gjithashtu objekt kryesor i aktivitetit te shoqërisë do te jete ai i agjencisë turistike dhe transportit turistik.

4.2 Për te bere te mundur arrijten e objektit te saj, Shoqëria me vendim të organit administrativ mund te nënshkruaje kontrata agjencie, komisioni, përfaqësie dhe mandati, te nënshkruajë marrëveshje qiraje, shitje, hipotekimi të pasurive te paluajtshme si dhe te nënshkruajë çdo kontrate tjetër te nevojshme për arrijten e objektit te mësipërm. Shoqëria mund te kërkojë kredi si dhe të japë dorëzani dhe garanci të tjera reale apo personale për detyrimet e saja, apo të të tretëve.

4.3 Me qëllim arrijten e objektit te saj, Shoqëria me vendim të organit administrativ, mund te zotërojë ne mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kane objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të.

KAPITALI – PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

Neni 5. –

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë (njëqind mije) i cili ndahet ne 100 (njëqind) kuota me vlere nominale 1000 (një mije) Lekë secila. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në para nga Ortaku i Vetëm:

- **Nazmi Balla**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 07.01.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759, i cili zotëron 100 kuota, me vlerë nominale të përgjithshme 100.000 (njëqind mije) Leke, qe përbenë 100% te kapitalit te Shoqërisë;

**Neni 6. –
Ortaku i Vetëm**

6.1 Ortak i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) transferimin të të tretet e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si dhe me emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si dhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shpërndarjen e likuidimit të Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) e çdo vendim tjetër që sipas ligjit apo këtij statuti i takon Ortakut të Vetëm.

**Neni 7. –
Financimi i Shoqërisë**

7.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga Ortaku i Vetëm fondet e nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë.

7.2 Financimet e mëtejshme të Ortakut të Vetëm do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

**Neni 8. –
Barrët mbi Kuotat e Kapitalit**

8.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barre siguruese apo të drejta të tjera reale.


ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

**Neni 9. –
Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm. Administratori i Vetëm ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori i Vetëm përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori i Vetëm ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë pa asnjë kufizim kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqëse e derdhje shumëash nga këto llogari pa limit.

9.2 Administratori i Vetëm mund të ndërmarre apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që i konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të shoqërisë. Administratori i Vetëm emërohet për një kohëzgjatje pa afat. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.

9.3 Administratori gjatë kryerjes së funksioneve të tij, ndjek direktivat e Ortakut të Vetëm për aktet për të cilat kërkohet miratimi i tij. Administratori i Vetëm i ushtron të drejtat e mësipërme



drejtpërdrejt apo duke ja deleguar një pjese apo të gjitha personave të trete të zgjedhur prej tij. Administratori është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimeve të këtyre personave.

9.4 Administratori i parë i shoqërisë është **Z. Nazmi Balla**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me datë 07.01/1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759, banues në Bulevardi Zogu I, nr. 62/2, Ap. 19 IV, Tiranë.

KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË

Neni 10. –

Kontrolli Kontabël

10.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emëroje një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

Neni 11. –

Viti Financiar

11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë pranë Regjistrimit Tregtar.

Neni 12. –

Bilanci dhe Rezervat

12.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i Vetëm merr masat e nevojshme për hartimin e projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaku i Vetëm të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

12.2 Ortaku i Vetëm vendos mbi ndarjen dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lënë mënjanë shumat e nevojshme për krijimin e Rezervës së Ligjore. Rezerva e Ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lënies mënjanë të një shume të barabartë me 5% të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

12.3 Ortaku i Vetëm në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masën e tyre.


PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 13. –

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

13.1 Në çdo moment e për çdo arsye që mund të arrihet në shpërndarjen e Shoqërisë, dispozitat për kryerjen e likuidimit dhe emërimin e likuidatorit janë ato që parashikohen nga ligji shqiptar në fuqi.





DISOPZITA PERFUNDIMTARE

Neni 14. –

Ligji i Aplikueshëm

14.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

Nazmi Balla:

Nazmi Balla


Nazmi Balla

Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Balla Tours Shpk.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1103 Rep.

Nr. — Kol.



VERTETIM

Sot me date 18.11.2005 (dymije e pese), para meje Noterit te Dhomës se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht Z. **Nazmi Balla**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 07.01.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0189759, banues ne Bulevardi Zogu I, nr. 62/2, Ap. 19 IV, Tirane., madhor e me zotësi te plote për te vepruar, i cili me vullnetin e tij te lire e te plote, me deklaroi se statuti i bashkëngjitur është hartuar ne përputhje me vullnetin e tij dhe e nënshkroi atë ne praninë time. Unë Noteri e vërtetojë këtë nënshkrim sipas ligjit.

NOTERI

~~NOTERE~~
MARGENA ÇELA
CEL: 069 21 21 624

